

Mblidhet Këshilli Kombëtar i BSPSH

Protesta nëse rritet çmimi i energjisë elektrike



Këshilli Kombëtar i BSPSH u mbledh një ditë pas mbledhjes së ERE më 06.12.2014. Në këtë mbledhje morën pjesë dhe seksionet kryesore të BSP të Tiranës dhe rajoneve të tjera që bëjnë pjesë në BSPSH. Në këtë mbledhje ju bë një analizë protestës së 22 nëntorit 2014 dhe hapave të mëtejshme që do të ndërmerren. Presidenti i BSPSH Gëzim Kalaja gjatë fjalës së tij u ndal në protestën e 22 nëntorit e cila sipas tij për nga pjesëmarrja ka ndodhur vetëm në vitet 1990-1991. Ai përshëndeti opozitën dhe grupet e interesit që iu përgjigjën thirrjes së BSPSH për të protestuar dhe të gjithë qytetarët. Tepër kritik , z. Kalaja u shpreh përsa i përket reformës që po ndërmerret në arsim dhe shëndetësi, për pezullimin e lejeve të ndërtimit e cila ka nxjerrë të papunë mijra punëtorë dhe për çmimit e çimentos duke rrezikuar punën në këto fabrika. Presidenti i BSPSH z. Kalaja falenderoi Sharan Burrow Sekretaren e Përgjithshme të Konfederatës Botërore të Sindikatave (ITUC) për mbështetjen që i dha BSPSH -së duke ju

drejtuar qeverisë shqiptare.

Fjala e Presidentit të BSPSH – Gëzim Kalaja

“Ka një çoroditje në të gjitha strukturat qeverisëse, sepse në takimin me ERE ne u ndodhëm përballë një të papriture. Ditë përpara bëhesh fjalë për ngritjen e çmimit të energjisë me 12.32, në mbledhjen e ERE na u komunikua 12.03, ndërsa sot në shtyp nuk do të ketë rritje më tepër se 9.9. Përsa i përket protestës, dua të falenderoj në mënyrë të veçantë të gjitha strukturat e BSPSH, të gjithë sindikalistët, qytetarët me bindje të majta dhe të djathta, veçanërisht opozitën, grupet e interesit të cilët ju bashkëngjiten protestës së BSPSH. Siç e deklarova dhe në protestë, ajo ishte një nga protestat më të fuqishme pas asaj të përmbysjes së diktaturës. Nuk mundën dot, as shtypi pranë qeverisë, as kritizerët, analistët, të sfumojnë apo të zbehin protestën e 22 nëntorit. Protesta gjeti pasqyrim në televizionet dhe shtypin më prestigjioz të botës. Në atë protestë ishte revolta e shqiptarëve kundër masave drastike dhe shtrënguese që po ndërmer qeveria në drejtim të ekonomisë së shqiptarëve, me vendosjen e 31 taksave të reja, me rritje e çmimit të energjisë elektrike etj. Pyetjes sonë se sa debitore është qeveria ndaj faturave të energjisë elektrike përfaqësuesi i OSHEE iu përgjigj se është 5,4 miliard lekë, duke u justifikuar se ne i kemi qeverisë 6,1 miliard lekë borxh. Atëherë u bë një pyetje nga ana jonë, përse OSHEE në bashkëpunim me policinë nuk i shkon qeverisë për t’i ndërprerë dritat, komisariteve, bashkive, por marrin policinë, shkojnë nëpër familjet e shqiptarëve të cilët nuk kanë patur mundësi ta paguajnë energjinë elektrike. Përse erdhi protesta e 22 nëntorit? Protesta erdhi si rezultat i mungesës së vullnetit politik të qeverisë shqiptare për të zhvilluar dialogun social të kërkuar nga BSPSH që në muajin shtator. I jemi drejtuar disa herë ekzekutivit, kryeministrit Rama për t’u ulur në tavolinën e bisedimeve me BSPSH-në. Ka patur një mungesë të theksuar të vullnetit politik për të kontaktuar me BSPSH-në. Ju keni qenë pjesëmarrës të asaj proteste madhore, qytetarët dolën si rezultat i pakënaqësisë, kanë qenë me mijra qytetarë me bindje të majta dhe pa bindje politike, por u tubuan në shesh si rezultat i varfërisë ekstreme. Dhe në protestë ne i dhamë kohë qeverisë për dialog, asgjë nuk mund të zgjidhet pa dialog dhe kjo është një nga normat e para të demokracisë, ky është rekomandimi i BE ku ne kërkojmë të anëtarësohemi, i KE, i DASH, i të gjitha strukturave demokratike ndërkombëtare. Kur mungon vullneti politik për dialog, atëhere është e drejta universale e secilit prej nesh që të protestojë. Ne nuk kërkuam dorëheqjen e qeverisë, as të kryeministrit, as opozita nuk e bëri një gjë të tillë. Ajo ishte një protestë krejtësisht sociale që u mbështet fuqimisht nga qytetarët e Shqipërisë. Situata është e rëndë dhe në arsim. Skenari është i qartë për të larguar mësuesit nga puna dhe për të marrë ato të cilët kanë kontribuar për partinë në pushtet. Prandaj BSPSH për çeshtjen e arsimit ka ngulur këmbë dhe vazhdon të ngulë këmbë që qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme me inteligjencën superiore në Shqipëri. Dhe në SHBA ka patur probleme, por qeveria amerikane nuk i pushoi arsimtarët nga puna. I dërgoi në kurset e rikualifikimit duke i mbajtur të hapura vendet e punës dhe i ripunësoi ato. Absolutisht, BSPSH është dakort me reformat, por për ato reforma që i shërbejnë qytetarëve dhe arsimit shqiptar. Jo njërin arsimtar e heq se është jashtë profilit dhe tjetrin e mban në punë dhe po që jashtë profilit, mjafton që të jetë militant i partisë në pushtet. Ka me qindra shembuj. Ka një

terror të paparë psikologjik tek mësuesit. Do t'i thoja ministres së Arsimit të shkonte dhe të merrte kontakt me trupat pedagogjike të çdo qyteti të Shqipërisë dhe të dëgjojë mësuesit se çfarë thonë. Janë caktuar drejtorë shkollash njerëz të cilët nuk kanë lidhje fare me arsimin shqiptar. Këto nuk i them unë Presidenti i BSPSH-së, këto i kanë deklaruar mësuesit në takimet që kemi patur me to. Sot më shumë se kurrë, SPASH-it i duhet uniteti dhe solidariteti për t'i thënë ndal kësaj reforme të padrejtë, për t'i kërkuar ministres së arsimit të ulët në tavolinën e bisedimeve, sepse nuk jemi dakort për këtë reformë, por do të jemi dakort për reforma që do ta 'shëndoshnin' arsimin shqiptar. Ashtu siç ne jemi dakort që çdo qytetar në Republikën e Shqipërisë duhet ta paguajë energjinë elektrike, çdo biznesmen dhe industrialist. Besoj se i patë nëpërmjet TV karriget bosh në takimin me ERE-në. Karriget bosh i përkisnin të gjithë atyre sindikatave që e mbajnë veten për demokratike dhe në shërbim të punonjësve të Shqipërisë, dhe grupeve të interesit pranë qeverisë të cilët kanë deklaruar se ngritja e çmimit të energjisë elektrike është e domosdoshme. Dje në ballafaqimin para publikut nëpërmjet mediave nuk kishin fytyrë për të ardhur dhe për të deklaruar se janë dakort me vendimin e qeverisë. Ndërsa BSPSH dhe në kohën e qeverisjes 'Berisha' e ka kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, ka protestuar para kryeministrit, pamjet janë në arkivën e BSPSH-së, të televizioneve, derisa nënshkruam marrëveshjen e mirëkuptimit me qeverinë. Dhe që nga shkurti i vitit 2011 e deri sot vazhdon të jetë i pandryshuar çmimi i energjisë.”

Këshilli Kombëtar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë i propozon Qeverisë dhe ERE:

- 1-□□□ Mos heqjen e fashës prej 300 kw për mbrojtjen e shtresave në nevojë derisa të arrihet ulja e plotë e humbjeve joteknike. Marrja e masave organizative nga kompanitë e sistemit energjitik si: vendosja e matësve të energjisë dhe më vonë e matësve inteligjentë.**
- 2-□□□ Rishikimin e faturave abuzive□ dhe atyre afrofe për të gjithë qytetarët.**
- 3-□□□ Rishikimin e vlerës së kompensimit të propozuar për shtresat në nevojë deri në vlerën e plotë.**
- 4-□□□ Amnisti e plotë për kamat-vonesat e kaluara për të gjitha familjet.**
- 5-□□□ BSPSH mbështet propozimin e HEC-eve të vegjël për mos ndryshimin e çmimit aktual të shitjes që ata i bëjnë KESH-it□ duke respektuar kontratat e lidhura.**

Në të kundërtën do të ketë protestë të dytë e cila sipas z. Kalaja do të jetë më e fuqishme se e para. Kështu vendosën me votim anëtarët e Këshillit Kombëtar të BSPSH-së.